



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 33/6 Prot.

Tiranë, më 07.07.2025

V E N D I M

Nr. 159, Datë 07.07.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 265, datë 30.12.2024, e znj. L.D kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a (Qendra e Prodhimit të Naftës Kuçovë), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*¹”, “*gjendjes arsimore*” dhe “*çdo shkak tjetër*²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në dokumentacionin e dërguar, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Në shtator 2023, Kompania Albpetrol sha, rriti pagat për të gjithë punonjësit. Për punonjësit me arsim të lartë në pagë llogaritej edhe një shtesë për nivelin e diplomës. Për këtë, Dega e Kuadrit të QPN Kuçovë, dërgoi në sektor listën shumëemërore të punonjësve me arsim të lartë, ku figuroja edhe unë. Nga shtatori 2023 deri në shkurt 2024, shtesën në pagë për arsimin e lartë e kam përfutur edhe unë. Në muajin mars 2024, më hiqet kjo pagesë si edhe fillon ndalesa në bordero e shtesës së përfutur për muajt shtator 2023 - shkurt 2024, me shkresë të ardhur në SEK I, nga QPN Kuçovë. Unë punoj si k/op.prodhimi në SEK I. Arsytimi që përdoret për këtë

¹ Referuar vërtetimit datë 13.12.2024, të lëshuar nga Partia Socialiste Bashkia Kuçovë, vërtetohet se ankuesja është anëtare e Partisë Socialiste.

² Pa përcaktuar një cilësi apo karakteristikë personale.

ndalesë është se vendi i punës ku unë punoj nuk parashikohet në strukturën e vendeve të punës me arsim të lartë. Arsye që nuk qëndron sepse shtesa në pagë është për nivelin e diplomës që disponon, e jo për vendin e punës ku punohet.

Që nga momenti që jam diplomuar (2003-2008 UT, Fakulteti Histori-Filologji, Diplomuar Gjeografi), e deri më sot, kam kërkuar pranë QPN Kuçovë që të sistemohesha në një vend pune duke mu vlerësuar diploma që kam. Përgjigjet që më janë kthyer nuk kanë qenë asnjëherë bindëse. Edhe pse kanë qenë të gjitha mundësitë që të sistemohesha në një vend tjetër pune, që të ndihesha e vlerësuar lidhur me nivelin tim arsimor. Nga drejtuesit e QPN Kuçovë nuk ka patur dëshirë të mirë, për të më sistemuar.

Dua të bëj me dije se gjatë vitit 2022-2023, kam punuar edhe me turne dhe nuk më paguan asnjë ditë me turne, me logjikën se gratë nuk paguhen me turne. Pagesë me turne është bërë për punonjës që punonin vetëm turnin e parë. Për rastin në fjalë, kam folur me një avokat për tu sqaruar e orientuar për zgjidhjen e këtij problemi. Me të marrë vesh drejtoresha e QPN Kuçovë, më ka bërë presion pranë subjektit politik (PS) ku aderoj dhe unë. Në një kohë që mund të më sistemonte në një vend pune si arkiviste. Me drejtuesit e Kompanisë Albpetrol kemi bërë edhe një takim për këtë problem dhe ata ishin të gatshëm të na mbështesnin, por Drejtoresha ka kërkuar që të ndalej në bordero pagesa e marrë për nivelin e diplomës për periudhën shtator 2023 - shkurt 2024. Sa më sipër ju bëj me dije se kërkesat e mia i kam bërë me shkrim dhe i kam dërguar pranë QPN Kuçovë, Albpetrol sha, Këshillit Mbikëqyrës të Kompanisë Albpetrol, si dhe Ministres znj. B”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e pagesës së parashikuar nga rritja e pagave të bëra nga Kompania Albpetrol, për nivelin e diplomës që disponon, si dhe sistemimin në një vend pune, duke ju referuar arsimit të saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimor ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 33, datë 07.01.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqëria Albpetrol, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, vlerësim performance të tre viteve të fundit, etj).
 - Kopje të Vendimit nr. 10, datë 04.10.2023, të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së shoqërisë Albpetrol sh.a”, dhe të detajuar për strukturën dhe organikën e QPN Kuçovë.
 - Arsytet e anulimit të pagës për shtesën në pagë për ankuesen dhe kopje të dokumentacionit ligjor ku është mbështetur kjo vendimmarrje.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit, për punonjës të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesen, të cilëve iu është hequr shtesa në pagë.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit për aplikimet dhe kërkesat për pozicion të ri pune me arsim të lartë, që ka bërë ankuesja dhe përgjigjeve të dhëna nga punëdhënësi, për periudhën nga data 01.01.2021, deri më sot.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit, lidhur me pretendimin e ankueses për mospagesën e punës me turne.
 - Kopje të Statutit të Shoqërisë Albpetrol sh.a, të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë Albpetrol, Kontratës Kolektive të Punës dhe të Rregullores së Brendshme të QPN Kuçovë.
 - Informacion nëse këto çështje po ndiqen gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të Albpetrol sh.a/QPN Kuçovë.

Me shkresën nr. 59/1, datë 21.01.2025, Shoqëria Albpetrol, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Znj. L.D është punonjëse e Shoqërisë Albpetrol sh.a., nga data 20.05.1987 e në vazhdim duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës, znj. L.D ka mbajtur detyrat si më poshtë:

- Operatore shfrytëzimit të puseve pranë Ndërmarrjes NN Q. Stalin të shoqërisë Albpetrol Sh.A, nga data 20.05.1987 deri me datë 01.10.2011.
- Operatore Prodhimi pranë Qendrës QPH Patos të shoqërisë Albpetrol Sh.a., nga data 01.10.2011 deri me datë 20.06.2018.
- Përgjegjës Turni pranë Qendrës QPN Kuçovë të shoqërisë Albpetrol Sh.a, nga data 20.06.2018 deri me datë 01.09.2023.
- Kryeoperatore Prodhimi pranë Qendrës QPN Kuçovë të shoqërisë Albpetrol Sh.A, nga data 01.09.2023 e në vazhdim.

Mbështetur në Vendimin nr. 11, datë 04.10.2023 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol “Për miratimin e pagave të punonjësve të Shoqërisë Albpetrol”, është miratuar sistemi i pagave, duke realizuar rritjen e tyre, sipas veçorive të pozicionit të punës dhe kualifikimeve të punonjësve. Niveli i pagave sipas emërimit përkatës në strukturën organizative të miratuar, përfshin: pagën e pozicionit të punës dhe shtesat me karakter të përhershëm, ku përfshihen: (arsimi, vjetërsia në punë, kualifikimi, trajtimi ushqimor dhe antidoda).

Znj. L.D, aktualisht punonjëse e shoqërisë Albpetrol, me detyrë “Kryeoperatore prodhimi”, pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë, para ndryshimit të strukturës organizative ka mbajtur pozicionin “Përgjegjës turni”, në Sektorin e Parë, në Qendrën e Prodhimit të Naftës Kuçovë.

Struktura organizative (e mëparshme) e trajtonte këtë pozicion me nivel arsimor të lartë/të mesëm, edhe pse niveli arsimor nuk reflektonte ndryshim në aspektin e trajtimit financiar të punonjësit.

Struktura e re e pagave, e miratuar me datë 04.10.2023, me Vendimin nr. 11, të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, i dha vlerë financiare kualifikimit, sipas nivelit të studimeve (bachelor, master profesional/shkencor), si element shtesë mbi nivelin e pagës së pozicionit të punës.

Sa më sipër është përcaktuar në Urdhrin nr. 91, datë 13.03.2024 “Për zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, nr. 10, datë 04.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së shoqërisë Albpetrol dhe nr. 11, datë 04.10.2023 “Për miratimin e pagave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol, ku përcaktohet se: “Punonjësit e shoqërisë Albpetrol të paguhen në vlerën e pagës dhe nivelin arsimor të parashikuar për pozicionin e punës, sipas përcaktimit në tabelat referuese të Vendimit nr. 10, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 04.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së shoqërisë Albpetrol, dhe Vendimit nr. 11, të Këshillit Mbikëqyrës, datë 04.10.2023 “Për miratimin e pagave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol”.

Për pozicionin “Kryeoperator prodhimi”, pranë QPN Kuçovë, në të cilën ushtron detyrën znj. L.D, vendimi nr. 10, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 04.10.2023, parashikon nivelin arsimor “i mesëm”, çka nuk lidhet me trajtimin financiar për kualifikimin (arsimin e lartë).

Për më tepër, formimi arsimor i znj. L.D, e diplomuar për gjeografi në Fakultetin Histori-Gjeografi, nuk përputhet me profilin e pozicionit të punës (teknik naftë/industrinë hidrokarbure), pozicion në të cilin znj. L.D ka ushtruar detyrën për më shumë se 30 vjet.

Shoqëria Albpetrol trajtimin financiar të punonjësve të saj, të pasqyruar në vendimin nr. 10, datë 04.10.2023, të Këshillit Mbikëqyrës, e ka bazuar në vlerësim të analizës së pozicionit të punës dhe të kriterëve arsimore e profesionale që duhet të përmbushen nga punonjësi që ushtron detyrën në atë pozicion, mbështetur dhe në zbatim të:

- Ligjit nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”;*
- VKM nr. 526, datë 20.12.1958 “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar;*
- VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”;*
- VKM nr. 447, datë 03.06.2020 “Për emërimet e profesioneve e të punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, si dhe emërtimet e profesioneve e të punëve të personelit inxhiniero-teknik në industrinë e naftës e të gazit, që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftës-jellës dhe gazsjellës”;*
- VKM nr. 448, datë 03.06.2020 “Për miratimin e listës së profesioneve dhe të punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës”,*

dhe, në asnjë rast nuk është udhëhequr në këto analiza e procedura në emra të përveçëm të punonjësve apo në veçoritë individuale të tyre, që mund të bëjnë shkas për diskriminim për bindjet politike, gjendjen arsimore, ose me çdo shkak tjetër, sikurse znj. L.D kërkon të konstatojë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Pagesa e znj. L.D për nivelin e kualifikimit, për periudhën Shtator 2023 (kur ka hyrë në fuqi vendimi nr. 10, i sipërcituar) deri në shkurt 2024, lidhet me një gabim në përlogaritjen e shtesave mbi pagën e pozicionit të punës nga ana e sektorit të financës së Qendrës dhe për këtë arsye, është bërë ndalesa për shumën e përfituar padrejtësisht nga znj. L.D dhe punonjësit e tjerë të trajtuar në të njëjtën mënyrë, ndalesë e shtrirë në muajt pasardhës.

Ju bëjmë me dije se këto ndryshime në emërtesa të pozicioneve të punës kanë ardhur si nevojë e domosdoshme e përshtatjes së organikave pranë shoqërisë Albpetrol, konform dhe përcaktimeve ligjore me qëllim përfitimin e statusit të naftëtarit të punonjësve të cilët punojnë në sistemin e naftës.

Pretendimi i znj. L.D se është diskriminuar për shkak të “bindjes politike”, “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”, është tërësisht i pabazuar, pasi Shoqëria Albpetrol, nuk ka ndërmarrë veprime diskriminuese ndaj punonjësve të saj, por miratimi i tabelave të reja të pagave ka pasur si qëllim përshtatjen e tyre me legjislacionin në fuqi, si dhe unifikimin e pozicioneve të punës dhe emërtesave të tyre për të gjithë qendrat e prodhimit, sipas sektorëve respektivë që kryejnë punë apo procese teknologjike të njëjta/të ngjashme.

Përsa i përket pretendimit të znj. D se është diskriminuar për shkak të “bindjeve politike”, është tërësisht i pabazuar pasi Shoqëria Albpetrol, nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por vetëm të dhënat personale bazë të punonjësve, për të cilët është marrë dhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës, si dhe në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit në fuqi. Në asnjë praktikë apo shkresë të punëdhënësit Albpetrol, nuk është përmendur përkatësia politike e ndonjë prej punonjësve. Pala ankuese ka barrën e provës të vërtetohet me prova shkresore që Punëdhënësi, pra personi juridik Albpetrol, ka qenë zyrtarisht në dijeni të përkatësisë politike të ankueses, pasi është logjike që ta diskriminosh dikë për shkak të bindjeve politike, duhet të kesh dijeni mbi përkatësinë apo bindjet politike përkatëse.

Këto fakte hedhin poshtë çdo pretendim të diskriminimit të znj. L.D, që disponon për shkak të gjendjes arsimore apo çdo shkakut tjetër.

Me qëllim sqarimin sa më të drejtë të çështjes objekt gjykimi pranë institucionit tuaj, ju vendosim në dispozicion edhe raste të tjerë të punëmarrësve të cilët kanë qenë në të njëjtat kushte me znj. L.D dhe ndaj tyre është marrë masa “Kthimit të shumës së marrë më tepër”, shkresa nr. 146/1, datë 27.03.2024.

Së dyti, znj. L.D, sikurse e konfirmon në kërkesën e saj, për këtë çështje është pritur në takime të veçanta dhe është sqaruar nga drejtuesit më të lartë të QPN Kuçovë dhe të shoqërisë Albpetrol, përfshirë dhe Administratorin e saj.

Bashkëlidhur gjeni kërkesën e znj. L.D drejtuar zv. Kryeministres dhe Ministres, znj.B.B, Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, regjistruar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 419/1, datë 22.05.2024, përcjellë për trajtim nga shoqëria Albpetrol, me shkresën nr. 419/2, datë 13.06.2024 dhe për të cilën shoqëria Albpetrol ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 3560/1, datë 01.07.2024.

Sa për pretendimin e znj. L.D se mund të sistemohej në një vend pune si “Arkiviste”, rregullorja e shoqërisë parashikon se lëvizja në pozicionin e punës bëhet me vendim të titullarit të institucionit, pas vlerësimit të kërkesës për këtë lëvizje nga Qendra përkatëse apo vetë punonjësi. Në rastin konkret nuk ka pasur asnjë kërkesë nga znj. L.D pranë QPN Kuçovë, apo administratës qendrore, dhe as ndonjë propozim nga QPN Kuçovë drejtuar Administratorit të shoqërisë për lëvizjen e saj në një pozicion pune.

Përsa më sipër ne vlerësojmë të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore për shqyrtimin e pretendimeve të paraqitura nga znj. L.D”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesja nëpërmjet e-mail-it datë 27.01.2025, është njohur me përgjigjen e Shoqërisë Albpetrol, por nuk ka kthyer përgjigje.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 33/2, datë

18.03.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 27.03.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces

Seanca u zhvillua në datën e caktuar, me praninë e përfaqësueses³ së Shoqërisë “Albpetrol” sh.a, ndërkohë pala ankuese nuk u paraqit, por njoftoi nëpërmjet telefonit pamundësinë e pjesëmarrjes.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftua pala se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, pala kundër të cilës është bërë ankesa i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Heqja/ndalimi i shtesës në pagë i është bërë dhe punonjësve të tjerë, të cilët ishin në të njëjtat kushte si ankuesja, pra nuk ka vend për trajtim diskriminues për shkaqet e pretenduara nga ankuesja. Nuk ka patur kërkesë nga ankuesja për tu pozicionuar në një vend tjetër pune, tagër ky që i përket vetëm administratorit. Për punën jashtë orari të gjithë punonjësit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe ankuesja ka punuar me sistem tetë orësh. Ankuesja ka punuar prej vitesh pranë Shoqërisë, madje kohët e fundit është promovuar në punë”*.

Në përfundim të seancës, u kërkua nga KMD, të vihen në dispozicion të shqyrtimit të ankesës informacion dhe dokumentacion shtesë nga ana e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

Nga ana e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a, me shkresën nr. 2343, datë 07.05.2025⁴, u dërgua informacioni, përse u kërkua gjatë seancës dëgjimore të datës 27.03.2025. Në këtë përgjigje Shoqëria “Albpetrol” sh.a., informon se: *Në vijim të detyrave të lëna nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në seancën dëgjimore të zhvilluar më datë 27.03.2025, lidhur me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së znj. L.D, parashtrojmë qëndrimet tona si vijon:*

1. Lidhur me pretendimin e znj. L.D se është diskriminuar për shkak se nuk i janë paguar turnet e dyta dhe të treta, ju bëjmë me dije se:

Ankuesja znj. L.D ka punuar dhe punon me sistemin 8 (tetë) orë/ditë pranë shoqërisë Albpetrol Sh.A., vërtetuar kjo me vërtetimin nr. 190 prot., datë 27.03.2025, ndaj pretendimi i ankueses nuk qëndron.

Punë pranë shoqërisë Albpetrol sh.a për punonjësit, për të cilët puna është ndërtuar me tre turne, është organizuar: turni I (ora 07.00–15.00), turni II (ora 15.00–23.00), turni III (ora 23.00–07.00), ndërsa për punonjësit e administratës kohëzgjatja normale ditore e punës është 8 orë. Për efekt llogaritjeje të kohës së punës, muaji i punës për të gjithë punonjësit është mesatarisht 22 ditë.

³ Shtetasen E.Ç, përfaqësuar me autorizim Nr. 1595, datë 26.03.2025.

⁴ Administruar pranë Komisionerit me nr.33/4 prot., datë 12.05.2025.

Punonjësit me turne, të cilët punojnë sipas grafikut të përcaktuar nga përgjegjësi i Qendrës, janë të ndarë si më poshtë: Operator i pompave të ujit, Rojë magazine, elektrikist turni, dispeçer, ndihmës elektrikist turni, punojnë me turne me sistem 24 orësh, pasuar nga tre ditë pushimi.

Përgjegjës turni, Operator prodhimi, Ndihmësoperator prodhimi, operator i lëndës së parë, operator shkarkues uji, ndihmësoperator shkarkues uji, fugist, shofer kamionçine autoveture (me turne), punojnë me orar 8 orë/ditë.

2. Lidhur me pikën e dytë mbi mënyrën se si janë miratuar Vendimi nr. 11, i Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë Albpetrol Sh.A., datë 04.10.2023, "Për miratimin e pagave të punonjësve të Shoqërisë Albpetrol SH.A.", dhe Vendimi nr. 10, i Këshillit Mbikëqyrës, datë 04.10.2023, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së shoqërisë Albpetrol Sh.A.", ju bëjmë me dije se:

Bazuar në relacionin e grupit të punës të ngritur me urdhër të Administratorit, në përbërje të të cilit kanë qenë dhe përfaqësues të Sindikatës së Naftëtarëve, nënshkruese e Kontratës Kolektive, janë hartuar strukturat dhe tabelat e pagave, duke realizuar caktimin e tyre sipas veçorive të pozicionit të punës dhe kualifikimit që punonjësi duhet të ketë për atë pozicion pune.

Niveli i pagave, sipas emërimit përkatës në strukturën organizative të miratuar, përfshin: pagën e pozicionit të punës dhe shtesat me karakter të përhershëm, të tilla si: vjetërsia në punë, kualifikimi, trajtimi ushqimor dhe antidota.

Struktura e pagave, e miratuar me Vendimin nr. 11 të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë më 4.10.2023, i dha vlerë financiare kualifikimit, sipas nivelit të studimeve (bachelor, master profesional/shkencor), si element shtesë mbi nivelin e pagës së pozicionit të punës.

Në hartimin e projektvendimeve dhe materialeve shoqëruese, të finalizuara me miratimin e Vendimit nr. 10 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 4.10.2023, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së shoqërisë Albpetrol, dhe Vendimit nr. 11 të Këshillit Mbikëqyrës, datë 4.10.2023, "Për miratimin e pagave të punonjësve të shoqërisë Albpetrol, administrata e shoqërisë Albpetrol, në asnjë rast nuk është udhëhequr në këto analiza e procedura nga veçoritë individuale të punonjësve, çka mund të bëjnë shkak për diskriminim për raste të caktuara, si dhe për çdo shkak tjetër, sikurse znj. L.D kërkon të konstatohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ju bëjmë me dije se këto ndryshime në emërtesa të pozicioneve të punës kanë ardhur si nevojë e domosdoshme e përshtatjes së organikës së shoqërisë Albpetrol dhe të Qendrave të saj, konform përcaktimeve ligjore, me qëllim përfitimin e statusit të naftëtarit për punonjësit të cilët punojnë në sistemin e naftës.

Në shtesë të këtij informacioni, mund të sqarojmë edhe faktin që edhe në paditë e ngjashme të ngritura nga punonjës të caktuar me objekt "dëmshpërblim" (jo nga diskriminimi), Gjykata ka vendosur në favor të Albpetrol Sh.A.

3. Lidhur me pretendimin e ankueses, znj. L.D, se nuk i është marrë parasysh kërkesa për transferim në një pozicion që i përshtatet kualifikimit të saj, ju bëjmë me dije se:

- Mbështetur në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, në Statutin e Shoqërisë Albpetrol Sh.A., me nr. 1643/7 prot., datë 27.02.2012, si dhe në Rregulloren e Brendshme të shoqërisë Albpetrol Sh.A., e drejta për emërimin, largimin dhe transferimin nga detyra të punonjësve të shoqërisë është në kompetencë vetëm të Administratorit të Shoqërisë Albpetrol Sh.A., me statusin e punëdhënësit.

Referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, neni 158, Administratorët:

3. Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë.

Gjithashtu, Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të shoqërisë, në Kreun VII, neni 47, përcakton organet drejtuese të shoqërisë, të cilat janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Këshilli Mbikëqyrës;
3. Administratori.

Në kompetencat e Administratorit, referuar kësaj Rregulloreje, neni 49, janë parashikuar të drejtat dhe detyrat të cilat citojnë: Emëron dhe largon nga detyra punonjësit e të gjitha niveleve të shoqërisë, bazuar në Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe në Kodin e Punës.

Znj. L.D, me eksperiencë mbi 30 vjet punë pranë shoqërisë, ka fituar diplomë të studimeve të nivelit “master shkencor” në profilin “Mësues gjeografie”, në vitin 2008. Shoqëria Albpetrol, duke qenë shoqëri me profil të aktivitetit të vet “Prodhim dhe tregtim i naftës bruto”, në strukturën organizative nuk ka ndonjë pozicion pune që i përgjigjet formimit të lartë arsimor të znj. L.D.

Rezulton se, nga larmia e provave të vendosura në dispozicion në këtë çështje nga ana e palës ankuese, nuk ka asnjë shprehje kërkesë drejtuar Administratorit të shoqërisë Albpetrol Sh.A. për transferimin në detyrë, por vetëm një kërkesë drejtuar z. S.K, Drejtor Teknik pranë shoqërisë Albpetrol Sh.A.

Këto fakte hedhin poshtë çdo pretendim të diskriminimit të znj. L.D për shkak të gjendjes arsimore apo të çdo shkakut tjetër.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen në të drejtën e saj për kushte të njëjta pune dhe page;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e saj gjatë marrëdhënieve të punës, që në rastin konkret është mënyra se si subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, Shoqëria “Albpetrol” sh.a., ka respektuar standardet dhe kërkesat ligjore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës së ankueses.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Për të vlerësuar pretendimin për diskriminim për shkaqet e pretenduara të parashtruara nga ankuesja, në radhë të parë, Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm në të drejtën për punësim, në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Shoqëria “Alpetrol” sh.a., është një shoqëri aksionare me ofertë publike, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Tiranë, në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Biznesit*”, i ndryshuar. Shoqëria ka numrin unik të identifikimit (NUIS) J82916500U dhe ushtron aktivitetet në fushën e operacioneve hidrokarbure, që përfshin kërkimin dhe prodhimin, trajtimin, transportimin, magazinimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, “Alpetrol” sh.a., merret me furnizimin me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, tregtimin e energjisë elektrike, etj.

Znj. L.D është punësuar në Shoqërinë Albpetrol, me datë 20.05.1987, duke ushtruar për më shumë se 30 vite detyra të ndryshme në sektorin e prodhimit të naftës. Fillimisht, ajo ka punuar si Operatore e shfrytëzimit të puseve pranë Ndërmarrjes NN Q. Stalin deri më 1 tetor 2011. Më pas ka vazhduar si Operatore Prodhimi në Qendrën QPH Patos deri më 20 qershor 2018, kur është emëruar Përgjegjëse Turni pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë. Nga data 01.09.2023, ajo ushtron detyrën e Kryeoperatores së Prodhimit në të njëjtën qendër.

Në vitin 2008, znj. L.D përfundoi studimet e ciklit të dytë “Master shkencor” në degën “Gjeografi”, megjithatë profili i saj arsimor nuk përputhet me atë të industrisë së naftës, ku ajo ka ushtruar funksione teknike.

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Albpetrol, në datë 04.10.2023, miratoi Vendimin nr. 10 “*Për miratimin e strukturës dhe organikës*” dhe Vendimin nr. 11 “*Për miratimin e pagave*”. Me këto vendime u ristrukturua organika e shoqërisë dhe u përcaktua që shtesat mbi pagën bazë, përfshirë atë për arsimin e lartë, të llogariten vetëm nëse arsimi i punonjësit përputhet me profilin teknik të vendit të punës.

Referuar organikës së re të QPN Kuçovë, për Sektorin e Parë, në rastin e pozicionit që mban znj. L.D – “Kryeoperatore Prodhimi” – niveli i kërkuar arsimor, është i mesëm, çka do të thotë se arsimi i saj i lartë nuk i jep të drejtë për shtesë financiare për kualifikim, sipas strukturës së re të pagave. Referuar po kësaj organike, niveli arsimor i kërkuar dhe për pozicionet e tjera si Kryeoperatorë Prodhimi, në Sektorët e 2, 3, 4, dhe 5, është arsimi i mesëm.

Shoqëria Albpetrol me Urdhrin nr. 91, datë 13.03.2024, “*Për zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, nr. 10, datë 04.10.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shoqërisë” dhe nr. 11, datë 04.10.2023, “Për miratimin e pagave të punonjësve të Shoqërisë”*”, vendosi:

1. *Punonjësit e Shoqërisë Albpetrol të paguhen në vlerën e pagës dhe nivelin arsimor të parashikuar për pozicionin e punës, sipas përcaktimit në tabelat referuese të Vendimit nr. 10, datë 04.10.2023 dhe Vendimit nr. 11 datë 04.10.2023, të Këshillit Mbikëqyrës.*

2. *Për punonjësit, për të cilët, nga hyrja në fuqi e vendimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, pagesa nuk është bërë në vlerën e pagës dhe nivelin arsimor të parashikuar për pozicionin e punës, sipas tabelës referuese, të bëhen ndalesat në pagë, duke u pasqyruar në listëpagesat e muajit mars 2024.*

Shoqëria Albpetrol me urdhrin sipërcituar, ka vendosur që për të gjithë punonjësit pagesa të bëhet sipas arsimit të kërkuar nga pozicioni i punës, dhe jo sipas arsimit personal të punonjësit. Megjithatë, për periudhën shtator 2023 – shkurt 2024, për shkak të një gabimi në sektorin e financës së Qendrës, znj. L.D përfitoi gabimisht shtesën për arsim të lartë, e cila më pas u korrigjua me mbajtje nga paga në muajt në vijim. Ky veprim u zbatua për të gjithë punonjësit në të njëjtat kushte, jo vetëm për znj. L.D.

Znj. L.D ka pretenduar se është diskriminuar për shkak të bindjeve politike, gjendjes arsimore dhe mosrespektimit të orareve me turne. Shoqëria Albpetrol, në përgjigjet zyrtare, ka sqaruar se:

Pozicioni i saj i punës është me orë të zakonshme pune (8 orë/ditë) dhe nuk i nënshtrohet pagesës për turnet e dyta dhe të treta.

Nuk disponon asnjë informacion mbi bindjet politike të punonjësve, duke e bërë të pamundur diskriminimin mbi këtë bazë.

Nuk ka ndonjë kërkesë zyrtare të znj. L.D për transferim në një vend pune tjetër (p.sh. arkiviste) që të jetë adresuar administratorit, si i vetmi autoritet që ka kompetencën për ndryshimin e vendit të punës.

Me datë 22.05.2024, znj. L.D i drejtoi një kërkesë zv. Kryeministres dhe Ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. B.B. Kërkesa u përçoll më tej tek Albpetrol për trajtim, dhe me datë 01.07.2024, Shoqëria ktheu një përgjigje zyrtare, duke sqaruar të gjitha pretendimet dhe duke vënë në dukje që rasti nuk përmban elemente diskriminimi.

Me datë 27.03.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një seancë dëgjimore, ku u analizuan pretendimet e znj. L.D. Shoqëria Albpetrol parashtroi që:

Vendimet janë miratuar në mënyrë kolegjiale, me pjesëmarrjen e sindikatës dhe përfaqësuesve të administratës.

Struktura dhe pagat janë unifikuar për të gjithë qendrat dhe pozicionet teknike, bazuar në kualifikimet e kërkuara për pozicionin, dhe jo në profilin personal të punonjësve.

Edhe në çështje gjyqësore të ngjashme, gjykatat kanë vendosur në favor të shoqërisë Albpetrol, duke e konsideruar zbatimin e rregullt të vendimeve të saj si të ligjshëm.

Sa më sipër, rezulton se në kuadër të ristrukturimit të brendshëm të organikës dhe sistemit të trajtimit financiar të punonjësve, në datën 04.10.2023, Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë Albpetrol miratoi Vendimet nr. 10 dhe nr. 11, përkatësisht “Për miratimin e strukturës dhe organikës” dhe “Për miratimin e pagave”.

Këto vendime janë miratuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, si dhe në zbatim të një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave, ndër të cilat: VKM nr. 526, datë 20.12.1958, e ndryshuar; VKM nr. 514, datë 20.09.2017; VKM nr. 447 dhe nr. 448, të datës 03.06.2020. Këto akte përcaktojnë ndarjen e profesioneve dhe emërtimet përkatëse sipas zhvillimeve të teknologjisë dhe organizimit të punës, si dhe parimet mbi trajtimin financiar të punonjësve në këtë industri, përfshirë kërkesat arsimore për çdo pozicion pune.

Parimi thelbësor që rrjedh nga këto vendime është se trajtimi financiar, përfshirë shtesën për arsim të lartë, përfitohet vetëm kur niveli arsimor i punonjësit përputhet me profilin teknik të pozicionit që ai ushtron. Ky standard është i mbështetur edhe në nenin 115 të Kodit të Punës, i cili i jep punëdhënësit të drejtën të vendosë pagën dhe shpërblimet shtesë në përputhje me kërkesat specifike të vendit të punës dhe nivelin profesional të nevojshëm për ushtrimin e tij.

Znj. L.D, e punësuar pranë shoqërisë “Albpetrol” që prej vitit 1987, ka ushtruar funksione të ndryshme teknike në sektorin e prodhimit të naftës, përfshirë detyrat si operatore shfrytëzimi dhe më pas si kryeoperatore e prodhimit pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës në Kuçovë. Në vitin 2008, ajo përfundoi studimet e ciklit të dytë të arsimit të lartë në profilin “Gjeografi”, megjithatë ky arsimim nuk përputhet me kërkesat teknike të industrisë së naftës. Sipas strukturës së re të pagave të miratuar në vitin 2023, pozicioni që ajo mban kërkon një nivel arsimor të mesëm dhe jo të lartë universitar, çka bën që ajo të mos përfitojë shtesën për arsim të lartë. Kjo dispozitë është aplikuar njëtrajtësisht për të gjithë punonjësit që ndodhen në pozicione të ngjashme dhe që nuk përmbushin kriterin e përputhjes së arsimit me vendin e punës.

Mospërfshirja e saj në përfitimin e shtesës për arsim të lartë është pasojë direkte e mospërputhjes së profilit të saj arsimor me kërkesat teknike të pozicionit që ajo ushtron, dhe jo një formë diferencimi personal. Ky standard zbatohet për të gjithë punonjësit në mënyrë të njëtrajtshme, në përputhje me nenin 9 të Kodit të Punës, që ndalon trajtimin e pabarabartë në bazë të karakteristikave personale.

Për periudhën shtator 2023 deri në shkurt 2024, për shkak të një gabimi administrativ nga sektori financiar, znj. L.D përfitoi gabimisht shtesën për arsim të lartë. Pasi ky gabim u konstatua, u vendos korrigjimi i shumës së përfituar nëpërmjet mbajtjes graduale nga paga mujore. Kjo masë u ndërmor në përputhje me nenin 78 të Kodit të Punës, i cili parashikon mundësinë e korrigjimit të pagesave të tepërta me mbajtje proporcionale dhe të arsyetuara nga paga e punonjësit. Referuar Urdhrit nr. 31, datë 27.03.2024, të QPN Kuçovë, rezulton se ndalesa për pagën e përfituar për punonjësit që nuk ishte bërë në vlerën dhe nivelin arsimor sipas tabelave referuese, është bërë për ankuesen dhe për punonjësit: E.K, F.C dhe A.K. Pra, e njëjta masë u zbatua për të gjithë punonjësit në të njëjtën situatë, pa dallim apo trajtim të pabarabartë.

Lidhur me pretendimet për pagesën e turneve të dyta dhe të treta, shoqëria ka sqaruar se pozicioni i znj. L.D është me orar të zakonshëm pune prej 8 orësh në ditë dhe nuk klasifikohet si pozicion pune me turne, çka përjashton përfitimin e shtesave përkatëse. Ky përcaktim organizativ është në përputhje me nenin 84 të Kodit të Punës, i cili rregullon pagesën për punën me turne, dhe është zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë punonjësit në të njëjtin regjim pune.

Gjithashtu, është konstatuar se znj. L.D, nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë zyrtare për transferim në një pozicion tjetër pune, siç ka përmendur më pas në mënyrë joformale (p.sh. pozicioni i arkivistes). Në përputhje me nenin 23 të Kodit të Punës, çdo ndryshim i vendit të punës kërkon një kërkesë të mirëfilltë nga punëmarrësi dhe një vendim nga punëdhënësi, në këtë rast administratori i shoqërisë. Mungesa e një kërkesë zyrtare tregon se nuk ka pasur një proces të inicuar për ndryshim pozicioni dhe për rrjedhojë nuk mund të flitet për refuzim apo për mosveprim nga ana e punëdhënësit.

Në përfundim, nga analiza e dokumentacionit dhe rregullimeve përkatëse ligjore, rezulton se veprimet e ndërmarra nga shoqëria “Albpetrol” sh.a., kanë qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si dhe të motivuara nga ndryshimet objektive të strukturës funksionale të shoqërisë dhe se trajtimi financiar, përfshirë shtesën për arsim të lartë, përfitohet vetëm kur niveli arsimor i punonjësit përputhet me profilin teknik të pozicionit që ai ushtron.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblyerjes, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme nga ana e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., sa i përket trajtimit të saj gjatë marrëdhënieve të punësimit, krahasuar me kolegë të tjerë të cilat ndodhen në kushte të njëjta me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të saj, të lidhur domosdoshmërisht me “shkaqet” e pretenduara.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., lidhur me trajtimin e saj gjatë marrëdhënieve të punësimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, znj. L.D, nga ana e shoqërisë “Albpetrol” sh.a.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA